



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.103/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi-Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik “Socijaldemokratska Unija - SDU”- me seli në Prizren, parashtruar kundër kandidatit Nedžmidin Sejdlar - kandidat i pavarur për Kryetar Komune në Komunën e Dragashit, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

Hedhet poshtë e palejuar ankesa ZL.Anr.103/2025 e datës 05.10.2025, parashtruar nga subjekti politik “Socijaldemokratska Unija - SDU”- me seli në Prizren, paraqitur kundër kandidatit Nedžmidin Sejdlar - kandidat i pavarur për Kryetar Komune në Komunën e Dragashit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 05.10.2025 në PZAP, është parashtruar ankesë nga subjekti politik “Socijaldemokratska Unija - SDU”- me seli në Prizren, në të cilën pretendohet se kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Dragashit në Zgjedhjet lokale të datës 12 Tetor 2025, z. Nedžmidin Sejdlar, me datën 04.10.2025, në profilin e tij në Facebook, ka bërë një publikim ku përfshinte një formular të skanuar për paraqitjen e ankesës në PZAP, me të gjitha të dhënat personale të deputetes Duda Balje (numri personal, numri i telefonit dhe adresa). Parashtruesi i ankesës pretendon se Nedžmidin Sejdlar ka bërë shkelje të rëndë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 06/L-082, neni 41 neni 28), i cili ndalon qartë publikimin publik të dhënave personale pa pëlqimin e personit të cilit i përket ato. Gjithashtu , Kodit të Sjelljes Elektorale (neni 2 dhe neni 3), i cili ndalon synimin, frikësimin dhe shkeljen e privatësisë së kandidatëve dhe subjekteve politike. Tutje, parashtruesi i ankesës shton se ky publikim rrezikon sigurinë, privatësinë dhe integritetin personal të deputetes Duda Balje dhe gjithashtu përfaqëson një përpjekje për synim dhe frikësim politik. Si prova, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur: pamje nga ekrani (screenshot) i postimit në fjalë nga faqja në Facebook e Nedžmidin Sejdlarit dhe kopjen e formularit me të dhënat personale të publikuara publikisht.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 1 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se “Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, ndërsa PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.” Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet, 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9 dhe parag, 5 të këtij neni, të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin është përcaktuar “*Personi fizik ose juridik i cili ka interes ligjor mund të parashtrojë ankesë në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, të drejtat e të cilit janë shkelur sipas dispozitave të LZP-së ose rregullave zgjedhore.*

Sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe pretendimeve ankimore të ankuesit nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të parashtrohet ankesë e kësaj natyre. Rrjedhimisht, parashtrimi i ankesës së ankuesit (SDU) kundër kandidatit të pavarur për Komunë të Dragashit z. Nedžmidin Sejdilar, me pretendimin se i njëjti ka bërë shkelje të rëndë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 06/L-082, neni 41 neni 28), i cili ndalon qartë publikimin publik të dhënave personale pa pëlqimin e personit të cilit i përket ato, nuk hynë në kompetencat e ankesave të cilat mund të parashtrohen në PZAP.

Neni 115 LZP parasheh se, PZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore.

Sipas nenit 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ku ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Paneli vlerëson se ankesa në fjalë është e palejuar ngase me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregullat Zgjedhore, PZAP nuk ka kompetencën për të vendos sanksionimi apo marrja e masave tjera ligjore për shkeljet e pretenduar të ankuesit.

Prandaj, nga arsyet e theksuar më lartë, në pajtim me nenin 13 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 115 parag 1, nenit 119, nenit 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejueshme.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.103/2025 më datën 06.10.2025

Kryesues i Panelit,
Ramush Bardiqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LJP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.